



# FLETORJA ZYRTARE

E

## REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 13

2001

Prill

### P Ë R M B A J T J A

Vendim i KM Nr.138, datë 22.3.2001	Për disa ndryshime në vendimin nr.301, datë 14.6.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për masat e për zbatimin e ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, të ndryshuar me vendimet nr.402, datë 1.8.1994; nr.476, datë 4.9.1995; nr.526, datë 2.10.1995 dhe nr.234, datë 22.5.1999, të Këshillit të Ministrave.....	383
Vendim i KM Nr.191, datë 6.4.2001	Për disa shtesa në vendimin nr.408, datë 31.8.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve shtetërore”.....	384
Vendim i KM Nr.197, datë 6.4.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.....	384
Vendim i KM Nr.198, datë 6.4.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.....	385

**V E N D I M**  
**Nr.138, datë 22.3.2001**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.301, DATË 14.6.1993, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR MASAT E PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7698, DATË 15.4.1993,  
“PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE ISH-PRONARËVE””, TË  
NDRYSHUAR ME VENDIMET NR.402, DATË 1.8.1994; NR.476, DATË 4.9.1995, NR.526,  
DATË 2.10.1995;DHE NR.234, DATË 22.5.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 128, të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.301, datë 14.6.1993, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

- Shkronja “a” ndryshohet si vijon:

“a) Në të gjitha prefekturat, komisionet e kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve përbëhen nga 5 anëtarë, si më poshtë vijon:

1. Kryetarifunksionar

2. Nënkyetarijurist ose specialist, me arsim të lartë në fushën endërtimit

3. Specialisturbanist, inxhinier ose specialist me arsim të lartë

4. Specialisturbanist, inxhinier ose specialist me arsim të lartë

5. Specialistarkivist, sekretar me arsim të lartë

Emërimi dhe largimi nga detyra e kryetarit dhe i nënkryetarit të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve, do të bëhet me propozimin e prefektit dhe me miratimin e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve.”.

- Shkronja “b” ndryshohet si vijon:

“b) Emërimi dhe largimi nga detyra i anëtarëve të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve, do të bëhet me propozimin e kryetarit të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve, dhe me miratimin e prefektit.

Propozimet që paraqiten nga kryetarët e komisioneve të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve, do të jenë propozime alternative me dy kandidatë.

Nëse Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve nuk vendos për emërimin e kandidaturave të paraqitura, atëherë procedura e emërimit fillon nga e para, me kandidatura të reja.”.

- Shkronja “ç” ndryshohet si vijon:

“ç) Të gjithë anëtarët e komisionit do të punojnë me shkëputje nga puna.

Paga e kryetarit të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve do të jetë sipas vendimit nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, Lidhja I, B5.

Paga e nënkryetarit të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve do të jetë sipas vendimit nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, Lidhja I, C2.

Paga e anëtarëve të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve do të jetë sipas vendimit nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, Lidhja I, C3.”.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Lokal, prefekturat dhe Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Illir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.191, datë 6.4.2001**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.408, DATË 31.8.1999, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR PRIVATIZIMIN ME TENDER TË NDËRMARRJEVE  
SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin, mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, dhe të vendimit nr.195, datë 20.3.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr.408, datë 31.8.1999, të Këshillit të Ministrave, në kapitullin IX, bëhen këto shtesa:

a. Pas pikës 1, shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:

“1.1. Për rastet kur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendos për pavlefshmërinë e të gjitha ofertave të paraqitura, Agjencia Kombëtare e Privatizimit shpall një datë të re për paraqitjen e ofertave, në një afat jo më pak se 10 ditë, nga data e shpalljes së vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Njoftimi të përmbajë:

- Vendin, mënyrën, datën dhe orën e saktë për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.  
- Njoftimin se kushtet e ftesës për tender, të publikuara në raundin e parë, nuk kanë ndryshuar.

- Shkaqet e njoftimit të datës së re për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.”.

b) Pas pikës 2, shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje:

“2.1. Për rastet e mospjekjes së tenderit procedurat fillojnë nga kapitulli I.”.

2. Ky vendim i shtrin efektet edhe për tenderat e publikuar, para hyrjes në fuqi të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.197, datë 6.4.2001**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000, TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE  
BUXHETORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pagat e punonjësve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në lidhjen Nr.1 “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit” bëhen këto shtesa:

- a) Në shkronjën “A4” shtohen emërtimet  
“- Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve  
- Zëvendëskryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve  
- Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.”.
- b) Në shkronjën “A7” shtohet emërtimi “Sekretar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.
- c) Në shkronjën “B1” shtohen emërtimet:  
“- Drejtor i Regjistrisë Kombëtare të Zgjedhësve  
- Drejtor i Komisioneve Zgjedhore  
- Drejtor i Drejtorisë Juridike.”.
- ç) Në shkronjën “B2” shtohen emërtimet:  
“- Drejtor Drejtorie në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve  
- Jurist në Drejtorinë Juridike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.”.
- d) Në shkronjën “B3” shtohen emërtimet:  
- Zëdhënës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve  
- Informaticien në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve  
- Ndihmës i Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.”.
- dh) Në shkronjën “B4” shtohen emërtimet:  
“- Inspektor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve  
- Në paragrafin përgjegjës sektori në Presidencë, në Këshillin e Ministrave dhe Kuvend shtohet “dhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.”.
- e) Në shkronjën “C2” shtohen emërtimet:  
“- sekretare e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.  
- në paragrafin “redaktor, bibliograf, përkthyes, stenograf, asistent, inxhinier, inspektor, ekonomist, specialist në presidencë, në Këshillin e Ministrave, në Kuvend shtohet, “edhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.198, datë 6.4.2001**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në paragrafin e parë të pikës 19 bëhet ndryshimi si më poshtë:  
“- Akademik56870”
  2. Në lidhjen I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit, në klasën “B1”, shtohet emërtimi:  
“- Akademik”.
- Ky vendim hyn në fuqi më 1 maj 2001.

KRYEMINISTRI  
**Ilir Meta**

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,  
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 7.4.2001  
Doli nga shtypi më 9.4.2001

Tirazhi: 4200 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "At Gjergj Fishta", Tiranë

Çmimi: 50 lekë